V E N D I M
Nr.8, datë 25.3.2003

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Zija Vuci	Anëtar i	“	“
Gjergj Sauli	Anëtar i	“	“
Alfred Karamuço	Anëtar i	“	“
Kristofor Peçi	Anëtar i	“	“
Xhezair Zaganjori	Anëtar i	“	“
Petrit Plloçi	Anëtar i	“	“
Sokol Sadushi	Anëtar i	“	“

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 24.2.2003, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.15 Akti që i përket:

KËRKUES:1. XHAVIT BELIU, përfaqësuar nga avokate Liliana Ruli, me prokurë.

2. MUHAMER PAZARI, përfaqësuar nga avokat Riza Hicka, me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR: PETRIT KULLOLLI, përfaqësuar nga avokat Ilir Selenica, me deklarim.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr.8436, datë 17.10.1996 të Gjykatës së Rrethit Tiranë; nr.991, datë 15.1.1997 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr.342, datë 22.1.1998 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Kasacionit dhe nr. X-4, datë 19.12.2000 të Kolegjit Seleksionues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, si antikushtetuese.

Xhavit Beliu dhe Muhamer Pazari kanë kërkuar në Gjykatën Kushtetuese shfuqizimin si antikushtetues të vendimeve të sipërcituara duke parashtruar në kërkesa të veçanta pretendimet e tyre.

Kërkuesi Xhavit Beliu, i ka përqëndruar argumentet e tij për shkelje të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, në këto drejtime kryesore:

- Është shkelur parimi procedural që gjykata duhet të shprehet për gjithçka që kërkohet, por pa i kaluar kufijtë e shqyrtimit të çështjes. Gjykatat kanë vënë të paditurin në pozitën procedurale të kundërpaditësit, pa ngritur kundërpadi.

- Gjykata e Kasacionit ka udhëzuar, në vendimin e saj për kthimin e çështjes për rigjykim, zbatimin e dispozitave të Kodit Civil aktual për marrëdhënie në fushën e pronësisë të lindura përpara hyrjes së tij në fuqi. Kodi Civil i vitit 1982 (që duhet zbatuar në këtë rast) nuk njihte fitimin e pronësisë me bashkim e përzierje.

Kërkuesi Muhamer Pazari, ka arsyetuar në kërkesën e tij se trashëgimlënësja Maire Pazari dhe trashëgimtarët e saj nuk kanë qenë në dijeni të zhvillimit të këtij gjykimi. Nëna e tij figuron si paditëse në këtë gjykim, ndërkohë që ajo vetë nuk ka marrë pjesë dhe nuk ka autorizuar ndonjë përfaqësues për çështjen. Sipas kërkuesit është zhvilluar gjykimi pa dijeninë e tyre, duke cenuar të drejtën kushtetuese për një proces të rregullt ligjor.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sokol Sadushi, përfaqësuesit e kërkuesve e të subjektit të interesuar dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Me vendimin nr.221, datë 4.11.2002 Gjykata Kushtetuese ka refuzuar kërkesën e paraqitur nga Xhavit Beliu dhe Muhamer Pazari, për shkak se përbërja e saj nuk ka qenë e plotë dhe mendimet e gjyqtarëve janë ndarë në mënyrë të tillë që nuk arrihej të votohej për zgjidhjen përfundimisht të çështjes. Me krijimin e kushteve të favorshme për formimin e shumicës së kërkuar, Gjykata Kushtetuese, në bazë të nenit 74 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e

Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", rifilloi shqyrtimin e kësaj çështjeje.

Pretendimet e të dy kërkuesve janë përqëndruar në shkeljen e të drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor që kanë kryer gjykatat gjatë zhvillimit të gjykimit në të gjitha instancat.

Kërkuesi Xhavit Beliu ka argumentuar përpara Gjykatës Kushtetuese se shkelja e parimit të disponibilitetit nga ana e gjykatës, si dhe zbatimi i gabuar i ligjit në kohë, janë elemente që kanë ndikuar në cenimin e të drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor.

Gjykata Kushtetuese çmon se pretendimet e paraqitura nga kërkuesi Xhavit Beliu, të cilat lidhen me mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat dhe me thelbin e çështjes, nuk përfshihen në juridiksionin e saj kushtetues. Shkeljet e ndryshme ligjore, që mund të evidentohen nga palët gjatë proceseve gjyqësore, nuk lidhen pazgjidhshmërisht me konceptin kushtetues dhe të jurisprudencës europiane të së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Kompetenca e Gjykatës Kushtetuese për të shqyrtuar ankesat e individëve për shkelje të së drejtës për një proces të rregullt ligjor nuk ka për qëllim të dublojë dhe të spostojë të drejtën e gjykatave të sistemit të zakonshëm gjyqësor për të zgjidhur vetë çështjet. E drejta për një proces të rregullt ligjor përbën një nga të drejtat e parashikuara në Kushtetutën tonë dhe në Konventën Europiane dhe lidhet me garancitë që u ofrohen palëve gjatë një gjykimi, në drejtim të respektimit të atyre parimeve esenciale që përbëjnë thelbin e procesit. Standarde të tilla kushtetuese si: e drejta për t'iu drejtuar gjykatës, e drejta e mbrojtjes, paanësia në gjykim, gjykimi publik, prezumimi i pafajësisë etj., përbëjnë elementet kryesore që Gjykata Kushtetuese ka konsoliduar në jurisprudencën e saj për kuptimin sa më të plotë të së drejtës për një proces të rregullt ligjor.

Lidhur me pretendimin e paraqitur nga kërkuesi Muhamer Pazari, se gjykatat kanë zhvilluar një proces gjyqësor pa dijeninë e nënës së tyre dhe pa qenë ajo ose përfaqësuesi i saj i pranishëm në gjykim, Gjykata Kushtetuese çmon se e drejta për një proces të rregullt ligjor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të Konventës Europiane, në këtë rast është shkelur.

Maire Pazari, trashëgimlënësja e kërkuesit, figuron në gjykimet e zhvilluara nga të gjitha gjykatat si një ndër palët ndërgjyqëse. Nga shqyrtimi i provave të paraqitura në gjykimin kushtetues, si dhe nga dosja gjyqësore e administruar, rezulton e provuar se Maire Pazari nuk ka qenë në dijeni të zhvillimit të këtij gjykimi. Në prokurën që paditësit (familja "Beliu", etj.), kanë lëshuar për përfaqësuesin e tyre ndodhet një shënim me shkrim dore, i shtuar mbi numrin 10 të përfaqësuarve të tjerë, se Maire Pazari përfaqësohet me një prokurë tjetër nga Kadri Pazari. Në këtë prokurë nuk rezulton të ketë nënshkruar Maire Pazari, si dhe nuk janë pasqyruar elementet e domosdoshëm, që do të mund të vërtetonin ekzistencën e një dokumenti të tillë, si numri i repertorit, i koleksionit dhe data e nënshkrimit të saj. Njëkohësisht prokura që pretendohet të jetë lëshuar nga Maire Pazari nuk ndodhet e administruar në asnjë nga proceset gjyqësore që janë zhvilluar ndaj saj.

Ka qenë detyrë e gjykatës, që në fillim të procesit gjyqësor kur është formuar ndërgjyqësia që këtë parregullsi evidente të prokurës dhe të mospasjes së dijenisë nga pala për gjykim, ta evitonte duke kërkuar administrimin në dosje të prokurës së përfaqësimit në emër të Maire Pazarit. Zhvillimi i gjykimit në këtë mënyrë, si dhe fakti se efektet e këtij vendimi gjyqësor që ka marrë formë të prerë shtrihen edhe mbi Maire Pazarin, pavarësisht nga mosdijenia e saj për gjykimin, i ka vënë në pamundësi ligjore trashëgimtarët e saj për të kërkuar të drejtat e tyre në rrugën e zakonshme gjyqësore.

Në këto kushte, Gjykata Kushtetuese, çmon se procesi në të gjitha instancat gjyqësore është zhvilluar pa dijeninë e Maire Pazarit dhe të trashëgimtarëve të saj, gjë që përbën shkelje të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të Konventës Europiane për të drejtat e njeriut.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 131 shkronja "f" të Kushtetutës, si dhe neneve 72, 74 e 77 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

V E N D O S I:

- Shfuqizimin e vendimeve nr.8436, datë 17.10.1996 të Gjykatës së Rrethit Tiranë; nr.991,

datë 15.01.1997 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr.342, datë 22.1.1998 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Kasacionit dhe nr.X-4, datë 19.12.2000 të Kolegjit Seleksionues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, si antikushtetuese.

- Çështja dërgohet për shqyrtim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

MENDIMI I PAKICËS

Jam kundër qëndrimit të shumicës për këto arsye:

1. Nga materialet e çështjes, me prokurën që paditësit kanë lëshuar para noterit, rezulton se Maire Pazari, përfaqësohet nga Kadri Pazari. Sipas saj atë e ka nënshkruar dhe vetë Maire Pazari. Duke qenë kështu, me të drejtë gjykatat (ajo e faktit, gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë) janë mbështetur tek ky dokument zyrtar, i cili duhet të vlerësohet si i pakontestueshëm, përderisa ai nuk është goditur për falsitet apo si i pavërtetë.

Këtë fakt duhej ta vlerësonte në këtë mënyrë dhe shumica, që në raste të tjera nuk ka kontestuar vërtetësinë e akteve të tilla për aq kohë s'kanë qenë goditur për falsitet.

2. Palët në proces kanë shumë vite që kanë konflikte, prandaj kanë marrë pjesë dhjetra e dhjetra herë në gjykime të natyrave të ndryshme. Në këto gjykime që kanë qenë pjesëmarrës, nuk janë ngritur pretendimet që kërkuesit kanë parashtruar në kërkesën drejtuar kësaj Gjykate. Për më tepër, deri në vitin 2000, ata s'kanë bërë asnjë kërkesë kundër vendimeve përfundimtare.

3. Maire Pazari së bashku me 11 persona të tjerë kanë qenë pjesëmarrës në proces me cilësinë e paditësit. Ata janë të afërt midis tyre, gjë që dëshmon për të kundërtën e asaj që pretendon kërkuesi. Lidhur me këtë, paditësit e tjerë nuk kanë pretenduar asnjëherë në asnjë shkallë gjykimi se Maire Pazari s'ka pasur dijeni për gjykimin.

4. Nga studimi i akteve të krijohet përshtypja se pranimi ose jo i kërkesës lidhur me këtë problem, në fund të fundit është një çështje fakti, që i përket bindjes së brendshme të Gjykatës, vlerësimi i të cilit nuk është atribut i kontrollit kushtetues.

Në këto rrethana, çmoj se kërkesa duhej rrëzuar.

KRYETAR
Fehmi Abdiu